REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VORË

NJOFTIM

APLIKIME PËR PËRFITIMIN E BURSAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2026–2027

Bashkia Vorë njofton të gjithë nxënësit dhe prindërit e tyre se ka filluar procesi i aplikimit për përfitimin e bursave për vitin shkollor 2026–2027.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 10.10.2019, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", i ndryshuar, përfitimi i bursës bëhet në përputhje me kategoritë dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

Për të aplikuar, nxënësit duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës, sipas kategorisë ku bëjnë pjesë:

1. Pika 2.3/a – Nxënësit me statusin e jetimit

- Certifikatë personale (shkarkohet nga e-Albania);
- Certifikatë familjare (shkarkohet nga e-Albania);
- Vërtetim nga shkolla për regjistrimin, frekuentimin e rregullt dhe mosqenien mbetës;
- Vërtetim nga Njësia Administrative mbi statusin dhe pagesën e statusit të jetimit;
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (shkarkohet nga e-Albania, te rubrika "Dokumente me vulë elektronike", shërbimi "Vërtetim për individë të parregjistruar").

2. Pika 2.3/b – Nxënësit që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate

- Certifikatë personale (shkarkohet nga e-Albania);
- Certifikatë familjare (shkarkohet nga e-Albania);
- Vërtetim nga shkolla për regjistrimin, frekuentimin e rregullt dhe mosqenien mbetës;
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (shkarkohet nga e-Albania, te rubrika "Dokumente me vulë elektronike", shërbimi "Vërtetim për individë të parregjistruar");
- Vërtetim nga Njësia Administrative mbi statusin dhe pagesën e kujdestarisë.

3. Pika 2.3/c Nxënësit që gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe nxënësit me aftësi të kufizuara, të vërtetuara nga komisioni mjekësor

- Certifikatë personale (shkarkohet nga e-Albania);
- Certifikatë familjare (shkarkohet nga e-Albania);
- Vërtetim nga shkolla për regjistrimin, frekuentimin e rregullt dhe mosqenien mbetës;
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (shkarkohet nga e-Albania, te rubrika "Dokumente me vulë elektronike", shërbimi "Vërtetim për individë të parregjistruar");
- Vërtetim mbi statusin e invaliditetit para-tetraplegjik dhe pagesën e PAK (shkarkohet nga e-Albania ose merret pranë Njësisë Administrative).

4. Pika 2.3/ç Nxënësit me statusin ligjor të personave që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë

- Certifikatë personale (shkarkohet nga e-Albania);
- Certifikatë familjare (shkarkohet nga e-Albania);
- Vërtetim nga shkolla për regjistrimin, frekuentimin e rregullt dhe mosqenien mbetës;
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (shkarkohet nga e-Albania, te rubrika "Dokumente me vulë elektronike", shërbimi "Vërtetim për individë të parregjistruar");
- Vërtetim mbi statusin e personave që nuk shikojnë ose nuk dëgjojnë.

5. Pika 2.3/d – Nxënësit, fëmijë të personave që gëzojnë statusin e invalidit

- Certifikatë personale (shkarkohet nga e-Albania);
- Certifikatë familjare (shkarkohet nga e-Albania);
- Vërtetim nga shkolla për regjistrimin, frekuentimin e rregullt dhe mosqenien mbetës;
- Vërtetim mbi statusin e invaliditetit dhe pagesën e pensionit të invaliditetit të prindërve (shkarkohet nga e-Albania ose merret pranë Njësisë Administrative);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (shkarkohet nga e-Albania, te rubrika "Dokumente me vulë elektronike", shërbimi "Vërtetim për individë të parregjistruar")

6. Pika 2.3/dh) nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane, të cilët regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional;

- Certifikatë personale (shkarkohet nga e-Albania);
- Certifikatë familjare, (shkarkohet nga e-Albania);
- Vërtetim nga shkolla për regjistrimin, frekuentimin e rregullt dhe mosqenien mbetës;
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (shkarkohet nga e-Albania, te rubrika "Dokumente me vulë elektronike")
- Vetdeklarimin qe I perkasin pakicave kombetare

7. Pika 2.3/e Nxënësit e identifikuar si viktima të trafikimit të qenieve njerëzore, të cilët kanë humbur kujdesin prindëror

- Certifikatë personale (shkarkohet nga e-Albania);
- Certifikatë familjare (shkarkohet nga e-Albania);
- Vërtetim nga shkolla për regjistrimin, frekuentimin e rregullt dhe mosqenien mbetës;
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (shkarkohet nga e-Albania, te rubrika "Dokumente me vulë elektronike", shërbimi "Vërtetim për individë të parregjistruar");
- Vërtetim mbi statusin e viktimës së trafikimit;
- Vendim gjyqësor mbi humbjen e kujdestarisë prindërore.

8. Pika 2.3/ë Nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;

- Certifikatë personale (shkarkohet nga e-Albania);
- Certifikatë familjare (shkarkohet nga e-Albania);
- Vërtetim nga shkolla për regjistrimin, frekuentimin e rregullt dhe mosqenien mbetës;
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (shkarkohet nga e-Albania, te rubrika "Dokumente me vulë elektronike", shërbimi "Vërtetim për individë të parregjistruar");
- Vërtetim nga institucioni përkatës që konfirmon se prindi ka humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

9. Pika 2.3/f Nxënëset (vajza), të cilat ndjekin drejtimet mësimore mekanikë, elektroteknikë, elektronikë, përpunim druri, gjeodezi, shërbim mjete transporti, termo-hidraulikë;

- Certifikatë personale (shkarkohet nga e-Albania);
- Certifikatë familjare, (shkarkohet nga e-Albania);
- Vërtetim nga shkolla për regjistrimin, frekuentimin e rregullt dhe mosqenien mbetës;
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (shkarkohet nga e-Albania, te rubrika "Dokumente me vulë elektronike", shërbimi "Vërtetim për individë të parregjistruar")

10. Pika 2.3/g Nxënësit me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton

- Certifikatë personale (shkarkohet nga e-Albania);
- Certifikatë familjare, ku vërtetohet gjendja familjare me një prind gjallë (shkarkohet nga e-Albania);
- Certifikatë vdekjeje e prindit që nuk jeton;
- Vërtetim nga shkolla për regjistrimin, frekuentimin e rregullt dhe mosqenien mbetës;
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (shkarkohet nga e-Albania, te rubrika "Dokumente me vulë elektronike", shërbimi "Vërtetim për individë të parregjistruar")

11. Pika 2.3/gj Nxënësët, të cilat regjistrohen në arsimin profesional në të gjitha drejtimet mësimore, përjashtuar ato që përfitojnë nga shkronja "f", e këtij vendimi, trajtohen me 50% të bursës.

- Certifikatë personale (shkarkohet nga e-Albania);
- Certifikatë familjare, (shkarkohet nga e-Albania);
- Vërtetim nga shkolla për regjistrimin, frekuentimin e rregullt dhe mosqenien mbetës;
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (shkarkohet nga e-Albania, te rubrika "Dokumente me vulë elektronike", shërbimi "Vërtetim për individë të parregjistruar")

12. Pika 2.4/a Kriteri i degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm: nxënësit, të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional në drejtimet mësimore bujqësi, veterinari, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit;

- Certifikatë personale (shkarkohet nga e-Albania);
- Certifikatë familjare, (shkarkohet nga e-Albania);
- Vërtetim nga shkolla për regjistrimin, frekuentimin e rregullt dhe mosqenien mbetës;
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (shkarkohet nga e-Albania, te rubrika "Dokumente me vulë elektronike", shërbimi "Vërtetim për individë të parregjistruar")

AFATI DHE VENDI I DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Aplikimet dhe dokumentacioni përkatës dorëzohen nga nxënësit ose prindërit e tyre pranë shkollës ku nxënësi është i regjistruar dhe ndjek procesin mësimor.

Të gjitha institucionet arsimore duhet të përcjellin dokumentacionin e plotë të aplikimeve pranë Sektorit të Arsimit Parauniversitar, Shëndetit dhe Kulturës, në Bashkinë Vorë, jo më vonë se data 14.12.2026.

Bashkia Vorë ju falenderon për bashkëpunimin dhe ju fton të informoheni e të aplikoni brenda afateve të përcaktuara.